



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	09
Nr. Prot. Birr Prot. Prot.No.	05-2505
Nr. i faqeve Br.stranica No. pages	-12-
Data: Datum: Date:	25/04/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 206-23-2641-2-3-6/C278

SHËRBIM

“Elaborati gjeodozik për shpronsim të objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo)”

Numri i prokurimit: 206-23-2641-2-3-6

Operatori ekonomik: STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: 810834699

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

STUDIO HAPSIRA SH.P.K., MATI 1, PRISHTINË, 810834699. (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara më poshtë:

“Elaborati gjeozik për shpronim të objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo) me numër identifikues: 206-23-2641-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: Elaborati gjeozik për shpronim të objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo).

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon pas kryerjes së shërbimeve.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në Prishtinë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Nr.	Emertimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi Pa TVSH €	TVSH (%)	Çmimi për njësi ME TVSH €	Çmimi total me Tvsh
1	'Elaborati gjeozik për shpronim të objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo)''	copë	1	2,125.44	18%	2,508.00 €	2,508.00 €

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

2.1 Çmimi total i kontratës duhet të jetë: **2,508.00 €**; dymijepesëqindtetë Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitetohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Menaxheri i kontratës nga MSh është: **Arif Alimusaj**

Telefoni: **038 200-24 138**

E-mail: **arif.alimusaj@rks-gov.net**





Menaxheri i kontratës/Personi kontaktues nga OE: **Besart Halimi**

Telefoni: **044 536 914**

E-mail: **studiohapsira@gmail.com**

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	BESART HALIMI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	MANAXHER I PROJEKTI T
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.04.2023	Data:	25-04-2023
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

TERMAT E REFERENCES

SFONDI

Ministria e Shëndetësisë (MSH), për nevojat e Deposë Qendrore të Barërave, si dhe për akomodimin eventuale të stafit, planifikon të iniciojë kërkesën për shpronësimin e objektit dhe parcelës së regjistruar si pronë e NSH "Jedinstvo" (nën menaxhimin e AKP), në Zonën Industriale në Prishtinë.

Në kuadër të dokumentacionit që kërkohet për iniciimin e këtij shpronësimi, duhet të përgatitet elaborati gjeodezik sipas kërkesave të përcaktuara me kornizën ligjore në fuqi për Kadastër, të Drejta Pronësore, Shpronësim, si dhe mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes në punë.

Objekti i ofruar nga AKP është Ndërmarrja "Jedinstvo" (NGBG "Rilindja") i cili ndodhet në Zonën Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë:

1. AKP aset ID nr: PRN188
2. Kategoria e Asetit: Depo dhe Toke
3. Sipërfaqja e objektit në m²: Përafërsisht rreth 1,284.00 m² (për më saktësisht ndoshta duhet bërë edhe një matje)
4. Sipërfaqja e tokës në m²: Ngastra nr. 1504/17 = 2,725,00m² + Ngastra nr. 1504/16 = 3,525.00m² = **Total: 6,250.00 m²**
5. Lokacioni i asetit: Zona Kadastrale Prishtinë (Zona Industriale, Prishtinë-Fushë Kosovë)

1. QËLLIMI

Me qëllim të përgatitjes së elaboratit gjeodezik, MSH përmes këtij aktiviteti të prokurimit, do të angazhojë një Operator Ekonomik që i përmbushë kërkesat profesionale dhe teknike për shërbimin e kërkuar.

Pas përfundimit të këtij Elaborati do të iniciohet kërkesa për shpronësim në Departamentin për Shpronësim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

2. NJËSITË KADASTRALE PËR TË CILAT PLANIFIKOHET TË INICOHET SHPRONËSIMI

Parcela si dhe objekti për të cilat planifikohet të iniciohet kërkesa për shpronësim, dhe për të cilat kërkohet elaborati gjeodezik, janë në pronësi të NSH "Jedinstvo" (nën menaxhimin e AKP).

Parcela kadastrale është e regjistruar me nr. P-71914059-01504-17 , objekti është i regjistruar me nr i lëndës 011-030/04-0259616, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Prishtinë.

Dokumentacioni për iniciimin e shpronësimit duhet të azhurnohet me shënimet (të dhënat) gjeodezike pas përcaktimit të kufijve të pronave të cekura si gjendje e fundit .

2.1 Dokumentacioni që MSH duhet të vejë në dispozicion të Operatorit Ekonomik

MSH do të dorëzojë ofertuesit i cili shpallet fitues i tenderit, të dhënat të cilat i ka në dispozicion:

- Hapësirën e nevojshme për pronat,
- Certifikatat e Pronësisë
- Kopjet e Planit me Koordinata (printuar)

3. KËRKESAT PËR KOMPLETIMIN E ELABORATIT GJEODEZIK

3.1 Korniza ligjore e aplikueshme e aplikueshme për punimin Elaboratit Gjeodezik

Gjatë punimit, hartuesi i këtij elaborati duhet të përmbahet:

- Ligjit për Kadastër.
- Ligjit mbi RDPP.
- Ligjit mbi Shpronësimin.
- Ligjeve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.

3.2 Shërbimet e kërkuara nga Operatori Ekonomik

3.2.1 Kërkesat specifike

Për punimin e Elaboratin Gjeodezik, Operatori Ekonomik do të:

1. Siguroje koordinatat (Y, X, H, D) për rrjetin gjeodezikë referent nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, (me foto, skicën e matjeve, koordinatat (Y, X, H) në sistemin koordinatave Ref01),
2. sigurojë ortofotot zyrtare (produktet më të reja),
3. sigurojë skicat-planet kadastrale vektor zyrtare të azhuruara,
4. sigurojë nga Zyra Kadastrale Komunale, skicat e matjeve (manualet, koordinatat, numrat e ri, indikacionet e pronarëve,...) për të gjitha ndarjet- nëndarjet,
5. zhvillojë, stabilizoj, matë dhe barazojë rrjetin poligonal, sipas nevojës për matje gjeodezike shtesë,
6. plotësojë planin e situacionit me matjet gjeodezike shtesë dhe ato të siguruara nga Zyrat Kadastrale Komunale,
7. sigurojë Certifikatat mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme dhe të dhënat bazë për njësi në Zyrat Kadastrale Komunale në origjinal dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj,
8. bëjë llogaritjen dhe barazimin e sipërfaqeve për të gjitha ngastrat kadastrale të cilat parashihet të hyjnë në shpronësim, veç e veç,
9. harmonizojë sipërfaqet e llogaritura me ato në RDPP,
10. përpilojë regjistrin e koordinatave për të gjitha ngastrat kadastrale të cilat parashihet të hyjnë në shpronësim, veç e veç, dhe llogaritjet e sipërfaqeve nga koordinatat për gjendjen e vjetër dhe të re,
11. përpilojë regjistrin e fletëparaqitjeve, duke përfshirë të gjitha objektet në ngastrat kadastrale dhe pronarët përkatës, të cilat gjinden brenda vijës së paraparë të shpronësimit
12. paraqesë objektet që planifikohet të shpronësohen në regjistrin e fletëparaqitjeve (si vërejtje)
13. bëjë rekapitullimin e sipërfaqeve,
14. punojë raportin teknik,
15. Sipas nevojës dhe rekomandimeve të MSH, të bëjë plotësime në Elaboratin Gjeodezik.

3.2.2 Përbajtja dhe formati i elaboratit gjeodezik

A. Pjesa tekstuale

- Dokumentacionin mbi regjistrimin e kompanisë,
- Specifikimet teknike për hartimin e plotësimit të elaboratit të shpronësimit,
- Procesverbalin mbi kontrollimin e projektit nga punëdhënësi,
- Raporti teknik,
- Përshkrimi i punimeve me kushtet teknike,
- Regjistrin e koordinatave (Y, X, H, D) për: rrjetin trigonometrik dhe rrjetin poligonal,
- Koordinatat e vijës së re të shpronësimit (nga të dy anët).
 - Regjistrin e fletëparaqitjeve,
 - Regjistrin e barazimit të sipërfaqeve.
 - Rekapitullimin e sipërfaqeve,
 - Certifikatat mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme dhe Të dhënat Bazë për Njësi.

B. Pjesa grafike

Plani i Situacioni në përpjesë $P= 1: 1000$ ose $P= 1: 500$, i cili përmban:

- Ortofotot (produktet më të reja).
- Vijën e shpronësimit.
- Kufijtë e ngastrave kadastrale të cilat hyjnë në shpronësim (vektorët, plotësimet eventuale nga matjet gjeodezike shtesë në terren).
- Numrat e ngastrave kadastrale (gjendja e vjetër dhe e re- ri numërimi).
- Numrat e pikave kufitare të ngastrave kadastrale (në vijën e shpronësimit).
- Distancat e brinjëve të kufirit të ngastrave kadastrale (në vijën e shpronësimit).
- Numrat rendor sipas Regjistrit të fletëparaqitjeve,
- Kufijtë e Zonave Kadastrale.
- Kufijtë e Zyrave Kadastrale Komunale.

C. Dorëzimi i Kopjeve të Elaboratit

Kopjet e Elaboratit të dorëzohen në 5 ekzemplarë në lidhje të fortë, si dhe në formë elektronike.

LISTA E STAFIT TË PUNËTORVE TË ANGAZHUAR NË: Numri i Prokurimit: 617-23-799-2-2-1 – PROJEKTIT “Elaborati gjeozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinfo)” me nr te prokurimit: 206-23-2641-2-3-6

Nr	Emri dhe mbiemri I punëtorit	Aktiviteti i punës
1.	MIRANDA ZEKA	Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me përvojë mbi 10 vjeçare- Gjeodet i Licencuar Eksperte GIS
2.	BESART HALIMI	Bachelor i diplomuar i Gjeodezisë me përvojë mbi 5 vjeçare – Gjeodet i licencuar nga AKK

STUDIO HAPSIRA SH.P.K – PRISHTINË



Prokurimi: 206-23-2641-2-3-6

Nr i brendshëm:

Tituli: Elaborati gjeozozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinfo)

1 Elaborati gjeozozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinfo)

Kodi i tenderit: 206-23-2641-2-3-6

Data: 31.03.2023

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1.pdf
2.	Certifikatat e Biznesit Tvsh dhe Numrit Fiskal Studio Hapsira shpk.pdf
3.	lista e projekteve - Studio Hapsira sh.p.pdf
4.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 1.pdf
5.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 2.pdf
6.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 3.pdf
7.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 4.pdf
8.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 5.pdf
9.	Kontrata referenca Studio Hapsira 6.pdf
10.	Kontrata Referenca Studio Hapsira 7.pdf
11.	Lista e Stafit Studio Hapsira shpk.pdf
12.	Miranda Zeka.pdf
13.	Besart Halimi.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Elaborati gjeozozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinfo)	Pjesa II.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ZAGREBIT , P.N., -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 206-23-2641-2-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **STUDIO HAPSIRA SH.P.K., MATI 1, 10000, PRISHTINË, Kosovë**

E-mail: **studiohapsira@gmail.com**

Personi kontaktues: **Edmond Halimi**

Telefoni: **045/150123**

Faxi:

Numri fiskal: **810834699**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-23-2641-2-3-6

Titulli i kontratës: Elaborati gjeodozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo)

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Elaborati gjeodozik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo)

3. Çmimi total i tenderit është:

2,508.00 EUR

Dhe në fjalë **[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]**

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

Deklaratë e garantuesit

GARANCI KONTRATE
POLICA NR. 070010260006902

Për: **MINISTRIA E SHENDETESISE**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: **STUDIO HAPSIRA SH.P.K**
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: 'Elaborati gjeozodik për shpronsim te objektit të ofruar nga AKP (Jedinsfo)

Numri i Prokurimit: 206-23-2641-2-3-6

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtënëshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 250.80 € Dy qinde e Pesedhete e Tete / njeqind Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivist se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 250.80 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 19.7.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Qamil Hoxha, nr.51, Prishtinë

Data: 20.4.2023